



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



DHOMA KOMBËTARE E NDËRMJETËSVE

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr. 17 Prot. datë 30/3/2023

Nr. 763 Prot datë 29.03.2023

## MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

### NDËRMJET

DHOMËS KOMBËTARE TË NDËRMJETËSVE

DHE

DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

*“Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, dhe promovimin e shërbimit të ndërmjetësimin, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe ligjit nr.10 385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” (ndryshuar me ligjin nr. 81/2013, datë 14.2.2013, nr. 26/2018, datë 17.5.2018) (i përditësuar, 2013)”.*

Kjo marrëveshje lidhet sot më datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

## NDËRMJET

**Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas** me adresë: Rruga “*Jordan Misja*”, Godina nr. 3, Tiranë, përfaqësuar nga z. Ergys Qirici, Drejtor i Përgjithshëm.

### Dhe

**Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve** me adresë: Rruga Brigada e 8-të, Pallati 8, kati 4, Ap 1, Tiranë, përfaqësuar nga zj. Drita Avdyli, Kryetare.

Duke qënë se Palët,

*Vlerësojnë* rëndësinë e sistemit të ndihmës Juridike të garantuar nga shteti në kuadër të rritjes së aksesit në drejtësi për qytetarët si një parim themelor kushtetues.

*Konsiderojnë* se një ndër elementët kyç të aksesit në drejtësi është sigurimi i ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike të garantuara nga shteti në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive dhe ndërmjetësimi, si një procedurë e zgjidhjes jashtëgjyqësore të konflikteve.

*Afirmojnë* vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje.

*Kanë rënë dakord* të lidhin këtë marrëveshje mirëkuptimi në vijim e quajtur *Marrëveshje*.

### Neni 1

#### Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje mes Palëve konsiston në vendosjen e bashkëpunimit sa i përket shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti me qëllim ndërmarrjen e masave për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve dhe në veçanti të grupeve vulnerabël si dhe promovimin e shërbimit të ndërmjetësimit.

### Neni 2

#### Baza Ligjore

Kjo marrëveshje mirëkuptimi bazohet në nenin 8 shkronja “e” të ligjit nr.111/2017 “*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*”, ligjin nr.10 385, datë 24.2.2011 “*Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve*” (ndryshuar me ligjin nr. 81/2013, datë

14.2.2013, nr. 26/2018, datë 17.5.2018) (i përditësuar, 2013), ligjin nr. 37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”, “Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë” miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 dhe ndryshuar me ligjet nr.8431, datë 14.12.1998; nr.8491, datë 27.5.1999; nr.8535, datë 18.10.1999; nr.8812, datë 17.5.2001; nr.9953, datë 14.7.2008, nr.10 052, datë 29.12.2008, nr.49/2012; 122/2013; 160/2013.

### Neni 3

#### Qëllimi

Palët bien dakord të bashkëpunojnë mbi:

- Promovimin e ndërmjetësimit dhe sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti përmes zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese; edukimit ligjor apo afishimit të materialeve të vizibilitetit;
- Shkëmbimin e përvjes në kuadër të përmirësimit të politikave shtetërore në fushën e ndihmës juridike dhe ndërmjetësimit;
- Zhvillimin e takimeve për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët;
- Planifikimin dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta në këtë kuadër;
- Kryerjen e analizave dhe studimeve të përbashkëta me qëllim nxjerrjen e rekomandimeve të karakterit ligjor dhe administrativ dhe vënien e tyre në dispozicion të palëve, të cilat do të vlerësojnë nevojën dhe formën e ndërhyrjeve konkrete bazuar në kompetencat ligjore ;
- Referimin e rasteve për të përfutur ndihmë juridike parësore falas pranë ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore;
- Bashkëpunimin në kuadër të një projekti pilot pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës.

### Neni 4

#### Personat e kontaktit

Secila nga palët cakton një person kontakti të cilit i drejtohen të gjitha komunikimet qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu edhe të shtypura në letër.

Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje personat e kontaktit janë si vijon:

Për Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve:

Emër Mbiemër: Enis Adgeli

E-mail: info@dku.gov.al

Për Drejtorinë: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas:

Emër Mbiemër: Erqyp Qirici

E-mail: erqyp.qirici@drejtisio.gov.al

Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, mbi të dhënat e personit të ri të kontaktit.

#### Neni 5

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

#### Neni 6

### Dispozita të fundit

Kjo marrëveshje nuk është burim i krijimit të detyrimeve monetare dhe financiare ndërmjet palëve.

Çdo palë merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshjeve pa pretendim financiar ndaj palës tjetër.


Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

Kjo marrëveshje mirëkuptimi hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

**Për Drejtorinë e Ndhmës  
Juridike Falas**

---

**Z. Ergys Qirici  
Drejtor i Përgjithshëm**



**Për Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve**

---

**Zj. Drita Avdyli  
Kryetare**

A large, stylized handwritten signature in blue ink, written over a horizontal line. The signature is cursive and appears to read "Drita Avdyli".